



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 7513 Prot.

Roskovec, më 26.12 2019

VENDIM

Nr. 113 datë 20/12 /2019

PËR

ANULIM TË VENDIMIT NR.104 DATË 22.11.2019

“PËR MIRATIMIN E VARIANTIT TË NDRYSHIMIT TË PROJEKTIT “PËR
RIKUALIFIKIM URBAN DHE ZHVILLIMIN E BLOKUT NR.2,QENDRA E
QYTETIT ROSKOVEC

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore ” neni 54,55 pika 6,Ligjin Nr.107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”i ndryshuar neni 12 , Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”neni 113,shkresës Nr.1825/1 datë 05.12.2019 të Prefektit të Qarkut Fier,Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Anulimin e VKB Nr.104 datë 22.11.2019 “Për miratimin e variantit të ndryshimit të projektit “Për rikualifikim urban dhe zhvillimin e Bllokut Nr.2,Qendra e qytetit Roskovec”.
Në shkresën Nr.1825/1 datë 05.12.2019 “Kthim përgjigje për ligjshmërinë e vendimit të Këshillit Bashkiak Roskovec” Prefekti i Qarkut Fier konstaton se objekti i këtij vendimi nuk është kompetencë e Këshillit Bashkiak në bazë të ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar neni 12 “Përgjegjësitë e këshillit bashkiak”.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Kadri Hyska

